



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Data: 01 Gusht 2018

Njoftim

Fondi për sigurim shëndetësor, në pajtueshmëri me bisedimet dhe negociatat që u realizuan nga propozimet e Shoqatës së gjinekologëve privat të Maqedonisë, me qëllim të vlerësimit të punës së gjinekologëve amë dhe rritjes së kualitetit të shërbimeve shëndetësore që ju ofrohen të siguruarave, në seancën e Bordit drejtues të Fondit që u zhvillua me datën 29.07.2018, u vendos:

1. Rritja e vlerësimit të pikës së kapitationit të gjinekologëve amë nga 50,00 në 55,00 denarë/për çdo paciente që ka të përzgjedhur gjinekolog amë;
2. Rritja e kompenzimit financiar të gjinekologëve të përzgjedhur që udhëheqin rastet e lindjeve nëpër shtëpitë e shëndetit, ashtuqë në kohë të duhur të sigurohet kujdesi shëndetësor për gratë shtatzëne nëpër vendet ku mungon departamenti i gjinekologjisë dhe akusherisë në institucionet shëndetësore spitalore;
3. Për t'a avansuar statutin e gjinekologëve amë të kujdesit shëndetësor parësor dhe angazhimin më të madh të tyre për të rezultuar në uljen e nivelit të vdekshmërisë së foshnjëve dhe lehonave në Maqedoni, Fondi ka plotësuar Rregulloren për mënyrën e pagesës së shërbimeve shëndetësore të kujdesit shëndetësor parësor. Në këtë mënyrë, për herë të parë bëhet vlerësimi i punës respektivisht shërbimeve shëndetësore që gjinekologët amë që ju ofrojnë grave shtatzëna. Kapitacioni bazë për veprimtarinë e gjinekologjisë për çdo femër shtatzëne me moshë mbi 12 vjeçe, do të llogaritet duke e shumëzuar me 2 pikë. Për pacientet e rëndomta që e kanë bërë përzgjedhjen e gjinekologut amë do të fitohet 1 pikë shtesë.

Kjo mënyrë e përlogarritjes së kapitationit për gratë shtatzëne do të aplikohet gjatë periudhës së shtatzënisë respektivisht deri në përfundimin e pushimit të lindjes por jo më shumë se 9 muaj.

Këto ndryshime do të hyn në fuqi nga data 01.09.2018

Me respekt, FSSHM